



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0589

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

S K, Ferizaj.

kundër

E paditura

NSH "Pasura Bujqësore" në Ferizaj, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Sabri Halili, dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-5883 të datës 27 shtator 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 26 tetor 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktvendimi i shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-5883 i datës 27 shtator 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me datë 18 gusht 2014, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë pa e specifikuar ndonjë vendim të Autoritetit të Likuidimit që ai donë të kontestoj me ankesë. Në ankesë paditësi ka kërkuar që atij ti paguhet pjesa e papaguar për 72 paga, në shumë prej 10.224,00 euro, për një periudhë të papërcaktuar, si dhe ka kërkuar që AKP-ja të përfshijë në Listën përfundimtare për 20%.

Më 28 shkurt 2022, Gjyqtari përgjegjës i lëndës i shkallës së I-rë të DHPGJS-së ka lëshuar një Urdhër për paditësin që ai të bëjë pagesën e taksës gjyqësore për ankesën nr.C-IV-14-5883, në shumën prej 30 Eurove, brenda 15 ditësh. Me anë të këtij Urdhri, paditësi është paralajmëruar se nëse nuk e paguan taksën brenda afatit ligjore prej 15 ditësh, ankesa e tij sipas nenit 253.4 dhe 253.5 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK), nenit 6.4, 6.5 dhe 10.40 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikim të tarifave të gjykatës, do të konsiderohet e tërhequr. Paditësi po ashtu është njoftuar se mund të parashtron kërkesën për lirim nga taksa gjyqësore në rast të mungesës së mjeteve financiare.

Urdhri është tentuar të dorëzohet tek paditësi më datë 29 mars 2022 dhe me datë 31 mars 2022, mirëpo ai dërgesën nuk e ka pranuar, ndërsa në bazë të raportit të postës të dhënë në këtë dërgesë thuhet se "Marrësi jashtë vendit deklaroi vëllai i tij S".

Me datë 11 gusht 2022, gjyqtari përgjegjës i lëndës i shkallës së I-rë të DHPGJS-së, lëshoi një Urdhër për Zyrën e regjistrimit, dhe Urdhëroi që Urdhri i datës 28 shkurt 2022, të publikohet në tabelën e shpalljeve të gjykatës dhe kësisoj të bëhet dorëzimi i Urdhrit për taksë. Në bazë të shënimit zyrtar të referentes së regjistrimit, që ekziston në dosje, ky Urdhër është publikuar në tabelën e shpalljeve nga data 15 gusht 2022 e deri me 22 gusht 2022. As pas këtyre veprimeve nuk është paguar taksa gjyqësore.

Me datë 27 shtator 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-14-5883, ankesën e paditësit e konsideron si të tërhequr. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se në bazë të nenit 253.4 të LPK-së, paditësi e ka pas për detyrë që bashkë

me ankesë të bashkëngjisë vërtetimin për pagesën e taksës gjyqësore. Gjykata me 28 shkurt 2022 e ka lëshuar Urdhrin për paditësin për pagesën e taksës gjyqësore në shumë prej 30 euro, duke e paralajmëruar se në rast se nuk e paguan taksën gjyqësore, apo nuk paraqitë kërkesë në gjykatë për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, ankesa do të konsiderohet e tërhequr. Paditësi Urdhrin për taksë nuk e ka pranuar edhe pse është tentuar të dorëzohet me datë 29 mars 2022 dhe me 31 mars 2022. Në bazë të raportit të postës të dhënë në këtë dërgesë thuhet se "Marrësi është jashtë vendit deklaroi vëllai i tij S". Tutje shkalla e I-rë konstaton se me datë 11 gusht 2022, është lëshuar një Urdhër për Zyrën e regjistrimit, dhe është Urdhëruar që Urdhri i datës 28 shkurt 2022, të publikohet në tabelën e shpalljeve të gjykatës dhe kësajsoj të bëhet dorëzimi i Urdhrit për taksë. Në bazë të shënimit zyrtar të referentes së regjistrimit, që ekziston në dosje, ky Urdhër është publikuar në tabelën e shpalljeve nga data 15 gusht 2022 e deri me 22 gusht 2022. As pas këtyre veprimeve nuk është paguar taksa gjyqësore. Paditësi nuk e ka lajmëruar gjykatën për ndërrimin e vendqëndrimit, dhe as që ka paguar taksën gjyqësore, që e kishte obligim në bazë të nenit 253 par 5 të LPK-së, andaj ankesa konsiderohet e tërhequr.

Me datë 24 tetor 2022, paditësi për mes postës e dërgoi në DHPGJS një ankesë kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-5883 të datës 27 shtator 2022. Paditësi në ankesë ka kërkuar që të priset Aktvendimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim. Paditësi në ankesë thekson se unë personalisht nuk kam qenë i njoftuar me Urdhrin për pagesën e taksës gjyqësore, nga se në çdo kohë unë do ta paguaja taksën gjyqësore, ose do të parashtroja kërkesë për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, si njeri i papunë. Ai pohon se dëshiron të kërkoj falje nga gjykata, ndërsa me rastin e dorëzimit të kësaj ankese unë do të paguaj taksën gjyqësore, edhe për ankesën paraprake. Andaj ai kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa, lënda të kthehet në rishqyrtim, dhe nëse ka ndonjë mangësi ankesa, atëherë gjykata të më informon për ndonjë dokumentacion shtesë që duhet eventualisht dorëzuar.

Me datë 20 dhjetor 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditëses. Në këtë parashtresë AKP-ja i kundërshton pretendimet ankimore të paditësit duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj, dhe e mbështet Aktvendimin e ankimuar të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, duke e konsideruar si të

drejtë dhe të bazuar në ligj. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se gjyqtari përgjegjës i lëndës i shkallës së I-rë të DHPGJS-së me datë 28 shkurt 2022, ka nxjerrë Urdhër për pagesën e taksës gjyqësore për ankesën e paditësit nr.C-IV-14-5883, në shumën prej 30 Eurove, brenda afatit prej 15 ditësh. Me anë të këtij Urdhri, paditësi ishte paralajmëruar se nëse nuk e paguan taksën gjyqësore brenda afatit ligjore prej 15 ditësh, ankesa e tij sipas nenit 253.4 dhe 253.5 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK), nenit 6.4, 6.5 dhe 10.40 të Udhëzimit Administrativ 02/2008 për Unifikim të tarifave të gjykatës, do të konsiderohet e tërhequr. Paditësi po ashtu është njoftuar se mund të parashtron kërkesën për lirim nga taksa gjyqësore në rast të mungesës së mjeteve financiare.

Urdhri është tentuar të dorëzohet tek paditësi më datë 29 mars 2022 dhe me datë 31 mars 2022, mirëpo ai dërgesën nuk e ka pranuar, ndërsa në bazë të raportit të postës të dhënë në këtë dërgesë thuhet se "Marrësi jashtë vendit deklaroi vëllai i tij S". Pastaj me datë 11 gusht 2022, gjyqtari përgjegjës i lëndës i shkallës së I-rë të DHPGJS-së, lëshoi një Urdhër për Zyrën e regjistrimit, dhe Urdhëroi që Urdhri i datës 28 shkurt 2022, të publikohet në tabelën e shpalljeve të gjykatës dhe kësisoj të bëhet dorëzimi i Urdhrit për taksë. Në bazë të shënimit zyrtar të referentes së regjistrimit, që ekziston në dosje, ky Urdhër është publikuar në tabelën e shpalljeve nga data 15

gusht 2022 e deri me 22 gusht 2022. As pas këtyre veprimeve nuk është paguar taksa gjyqësore.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së drejtë ka vepruar kur me Aktvendimin e ankimuar e ka konsideruar ankesën e tërhequr. Paditësi në bazë të nenit 253.4 të LPK-së dhe nenit 6 të Udhëzimit administrativ nr.2008/2 të KGJK-së për unifikimin e taksave gjyqësore, që ishte në zbatim në atë kohë, ishte e obliguar të paguaj taksën gjyqësore, mirëpo ajo ka dështuar të bëjë këtë.

Kolegji i Apelit vëren se ankuesi me ankesën në shkallën e dytë ka pohuar se ai personalisht nuk ka qenë i njoftuar me Urdhrin për pagesën e taksës gjyqësore, nga se në çdo kohë ai pohon se do ta paguaja taksën gjyqësore, ose do të parashtroja kërkesë për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, si njeri i papunë.

Kolegji i Apelit konstaton se në bazë të raportit të postës të dhënë në dërgesë, paditësi nuk është gjetur në shtëpi në adresën e tij të dhënë në ankesë. Ai sipas këtij raporti i cili bazohet në deklaratën e vëllait të tij S K, në konen e dorëzimit të këtij Urdhri ka qenë në botën e jashtme, ndërsa ndërrimin e vendqëndrimit të tij, ai nuk e ka lajmëruar në gjykatë, dhe as nuk ka caktuar ndonjë Avokat, për të pasur mundësi që gjykata të mbajë korrespondencën zyrtare me paditësin. Në bazë të nenit 116 paragrafi 1 të LPK-së, paditësi edhe pse nuk e ka ndërruar adresën fillestare, ai ishte i obliguar që për kohën sa e ka ndërruar vendqëndrimin ta lajmëroj gjykatën, në mënyrë që gjykata të mos ketë pengesa të realizoj korrespondencën zyrtare me paditësin. Për këtë çështje paditësi fare nuk është deklaruar në ankesë.

Andaj nga këto arsye, refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore:

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 30 euro me datë 12 dhjetor 2022, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit, me datë 26 tetor 2023.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtari kryesues _____